

## Gjuhësi ballkanike

# Mbi mohimin e dyfishtë e të shumëfishtë

Agim Spahiu

20 tetor 2001

### Përmbledhje

Në këtë shkrim autori ka marrë në shqyrtim çështjen e mohimit të dyfishtë e të shumëfishtë që është e pranishme jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në maqedonishte e bullgarishte, në serbokroatishte, rumanishte, greqishte, madje edhe në turqishte. Kjo do të thotë se kjo është një dukuri gjuhësore që i takon edhe arealit gjuhësor ballkanik, pra është një element gjuhësor i tërë Ballkanit.

Quhen **mohime të dyfishta dhe të shumëfishta** të gjitha ato ndërtime morfo-sintaksore që në ligjërimin e folur e të shkruar mohojnë veprime në mënyrë të dyfishtë dhe të shumëfishtë.

**Mohimi i dyfishtë** realizohet zakonisht në njësitë sintaksore kumtuese - me anë të foljeve mohore, pjesëzave mohuese : *nuk, s' mos, pa* dhe të ndonjë *përemri të pacaktuar mohues*, si p. sh.: *askush, asnjë, asgjë, hiçgjë, hiçmosgjë, kurrëgjë, asgjësend, asgjëkafshë* etj., kurse **mohimi i shumëfishtë** nga foljet mohore, nga përemrat e lartshënuar të pacaktuar mohorë dhe nga trajtat ndajfoljore mohore të kohës, si: *asnjëherë, kurrë, kurrën e kurrës* etj.

Është karakteristike se ky element gjuhësor nuk ndeshet në numrin më të madh të gjuhëve perëndimore, si në gjuhën angleze, gjermane, frënge etj., ndërsa është shumë i shpeshtë në disa gjuhë ballkanike, si në **gjuhën shqipe, rumune, serbe, maqedonase, bullgare, greke, turke** etj. Sa për krahasim po i marrim disa shembuj nga këto gjuhë: **Në gjuhën shqipe** mund të thuhet: *Askush askujt s'i ka borrh; Asnjëherë asgjë nuk i kam thënë; Ata s'dinë kurrëgjë për këtë* etj.; **në gjuhën rumune**: *Niciunul din ei n - a facut nici o isprava; Pe o astfel de garantie, nimeni, cu drept cuvint, nu pune nici cel mai mic teimei; Nu invata nimeni nimic*<sup>1</sup>; **në gjuhën serbokroate**: *Niko ne govori; Nicega tu nema; Nista se ne cuje*.<sup>2</sup>; **në gjuhën bullgare**: *Nikom u nishcho ne som napravill; Njamah nikakvih grizhi*<sup>3</sup>; **në gjuhën maqedonase**: *Ne ostannuva nishta drugo; Toj ne*

<sup>1</sup>Shih ARSR, Grammatica limbii romane II, Bucuresti, 1966, f. 58.

<sup>2</sup>Shih M. Stevanovic, Savremeni srpskohrvatski jezik I, Bg., 1981, f. 301.

<sup>3</sup>Shih BAN, Gramatika na sovremennija bulgarski knizoven ezik III, Sintaksis, Sofija, 1994, f. 44.

e za nishto<sup>4</sup>; në gjuhën turke: *Onlar hiçbirsey bilmiyorlar; Kimse kimseye yok*<sup>5</sup>; dhe në gjuhën greke: *Oik eutin oiden kretton h zomoi polei*<sup>6</sup>.

Përdorimi i këtij elementi gjuhësor vetëm në gjuhët e përmendura është dëshmi që tregon se këtu kemi të bëjmë me një ndërtim gjuhësor ballkanik, pra që i takon lidhjes gjuhësore ballkanike.

Ky ndërtim nuk do të thotë se ka shtrirje të prerë vetëm në Gadishullin Ballkanik. Faktet gjuhësore dhe ato jogjuhësore nganjëherë edhe i tejkalojnë këto caqe, ngase ky ky shembull mund të ndeshet, për çudi, edhe në gjuhën ruse, ndonëse kjo e fundit nuk i takon arealit gjuhësor ballkanik. Lidhur me këtë dukuri **E. Çabej** në studimet e tij ka vënë re se *Ka ndonjë që nuk është vetëm e këtyre gjuhëve, por gjindet edhe në ndonjë gjuhë kufitare në këtë Gadishull*<sup>7</sup>.

Një ndërtim i këtillë, siç u tha edhe më lart, në disa gjuhë të Evropës Qendrore dhe Perëndimore, është i palejueshëm dhe i pakuptimtë. Kështu p. sh. autorët **Helbig/Buscha** në një gramatikë të tyre të gjuhës gjermane kanë pohuar në se: *Eine doppelte Negation ist in der deutschen Gegenwartssprache nicht zulässig, es sei denn als besonderes Stilmittel zur vorsichtigen Bejahung (nur in der Koppelung nicht - un - und in der Koppelung nicht ohne) : Er liest ein nicht uninteressantes Buch. (= ein ziemlich interessantes Buch); Er hat die Ansprache nicht ohne Spannung verfolgt. (= mit Spannung)*<sup>8</sup>. Madje ndërtimet gjuhësore me mohim të dyfishtë e të shumëfishtë, në gjuhët gjermanike, sidomos në gjuhën angleze, në shumë raste, po të përdoren, mund të sjellin edhe ndonjë pohim të sforcuar, çka do të thotë se shprehet e kundërta e asaj nga gjuhët ballkanike.

---

<sup>4</sup>Grup autorësh, Srpskohrvatski - makedonski rečnik, Skoplje, 1984, f. 199 dhe 233.

<sup>5</sup>Nga ligjërimi bisedor.

<sup>6</sup>Shih Music - Majnaric, Gramatika grckoga jezika, Zagreb, 1970, f. 242.

<sup>7</sup>Dr. E. Çabej, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1976, f. 83.

<sup>8</sup>Helbig/Buscha, Leitfaden der deutschen Grammatik, 1998, f. 199.